



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e XI-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 08.11.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 09.10.2024,
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për bashkëfinancim me qytetarë (ref. drejt. bujqësisë),
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt gusht-shtator 2024,
5. Të ndryshme.

01Nr. 06-36376 / 2024
Klinë, më 30.10 / 2024



Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Pozivajući se na član 52. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, član 33 Statuta opštine Klina, članovi 15 i 16 i 17 Poslovnika o radu Skupštine i opštinskih odbora, predsednik komiteta za politiku i finansije opštine Klina, vrsi sledece:

OBAVESTENJE

Pozivaju se svi članovi Odbora za politiku i finansije da učestvuju na 11. sastanku KPF-a koji se održava: 08.11.2024. godine u sali Skupštine opštine Klina, sa početkom u 09:00 časova..

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sastanka održanog 09.10.2024.
3. Razmatranje predloga-odluke za povećanje budžeta i izradu novog kodeksa za sufinansiranje sa građanima (odnosi se na poljoprivredu),
4. Razmatranje podnetih zahteva Odboru za politiku i finansije za avgust-septembar 2024. godine,
5. Razno.

01Br. 06-363761 2024
Klina, 30. 10/ 2024



Predsedavajuci
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

01 Nr. 320-359/5/24

Klinë, me dt. 28.10.2024

PËR : Asamblen Komunale Klinë z.Fadil Gashi

KOPJE: Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj,
Sherbimit të Kuvendit

NGA : z. Lorenc Marleku, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

LËNDA: Kërkesë për shtimin e pikes së rendit të ditë Lejimin e kodeve për alokimin e mejeveve financiare nga bashkfinancimi me qyrtate në proejktin mekanizmit bujqësor Freza për Traktor ,Shkepse plehu dhe koshere për Blet .

I nderuar,

Përmes kësaj kërkesë po ju drejtohem dhe lutemi juve si kryesues i Asamblese Komunale të lejoj krijimin e kodeve për alokimin e mjeteve financiare që do të krijohen (inkasohen) nga të hyrat e participimit nga projekti Mekanizem Bujqësor Freza për Traktor në vler 25.970

Shpermdase Plehu në vler 11.250 dhe Koshere Bletesh në vler 9999.9 nga bashkfinancimi i fermerëve

Ju faleminderit për mirëkuptimin e juaj!



Lorenc Marleku
Drejtor i Drejtorisë së DBPZHR



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr _____/24
Klinë, dt: _____/24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 09.10.2024, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Me autorizimin e kryesuesit mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i kuvendit, z. Tunë Deda, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorin e Financave, z. Enver Berisha, drejtorin e Administratës, z. Binak Syla, OSBE-në, policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Zv. Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

- 1. Arsyetimi i mungesave;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 06.09.2024;**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim të lokaleve komunale kompanisë NLP KRM “Ambienti” njësia në Klinë;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2024;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt shtator-tetor;**
- 6. Të ndryshme.**

Tunë Deda: Mirë se erdhët në Komitetin për Politikë dhe Financa. Rendin e ditës e keni marr, nëse ka dikush diçka për rend të ditës, urdhëroni! Kush është për rend të ditës?

Me 6 vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Tunë Deda: Mungon vetëm kryesuesi që është në udhëtim por pritet të bashkëngjitet me vonë nëse arrin.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 06.09.2024.

Tunë Deda: Kush është për miratim të këtij procesi?

Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim të lokaleve komunale kompanisë NLP KRM “Ambienti” njësia në Klinë.

Tunë Deda: Referon drejtori i Administratës, z. Binak Syla.

Binak Syla, drejtor i Administratës: Përshëndetje, kryesues, përshëndetje për gjithë të pranishmit! Ne, si ekzekutiv, e kemi pranuar një kërkesë nga KRM “Ambienti” me seli në Pejë, më datë 02.09.2024 . Kërkesa ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të dy lokaleve, pronësi e komunës që gjenden në objektin “Nojtra”. Ata kërkojnë që për shkaqe objektive të tyre, për interesa të kompanisë, për arsye se nuk kanë hapësirë të mjaftueshme zhvillimin e aktiviteteve të tyre dhe kërkojnë nga komuna që të ju ofrohet mundësia t’i japin dy lokale në shfrytëzim në afat tre vjeçar, duke i paguar të gjitha pagesat e qirasë konform rregulloreve në fuqi që e posedon komuna. Ata e kërkojnë që të futet në rend të ditës në seancën e radhës dhe të shqyrtohet kjo kërkesë në mundësi që komuna të ofrojë ato dy lokale në objektin e “Nojtres” qysh e thash. Nëse ju pajtoheni me procedura më tutje, është në kompetencën e juaj.

Tunë Deda: Faleminderit, drejtor! A ka dikush, urdhëro, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për gjithë! A ka mundësi që të ma sqaroni se ky lokali “Noitra”, ku i bie?

Binak Syla, drejtor i Administratës: Lokali është te “Raiffeisen bank”, ka qene përpara në shërbim të komunës, ne i kemi disa lokale aty, sa e di kemi 11 gjithsej dhe këta e kërkojnë në katin e tretë. Lokalet janë të pa meremetuara për arsye se gjendja e tyre është katastrofale, këta e marrin përsipër komplet renovimin, komplet mundësitë e aktivizimit të tyre të jenë sa më

funkionale dhe me sipërfaqe diku 32 metra katror është zyra. Ne disa herë kemi tentuar si komunë, kemi shkuar atje dhe kemi pastruar, po megjithatë, hapësira ka qenë jo e përshtatshme dhe aty kanë vendosur njerëzit gjëra gjithfarë të ndryshme, kështu që, mendoj që ndoshta kishte me qenë mirë edhe interes edhe i komunës që e merr edhe qiranë prej KRM “Ambientit”, po është në kompetencën e juaj të vendosni, faleminderit!

Tunë Deda: Faleminderit, drejtor! Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, drejtor! Po tash e kuptuam, dmth aty ku ka qenë ish-gjykata dhe shoqatat e luftës, po kur është një vendim i mirë dhe është edhe në interes të komunës, pse mos të mbushet edhe buxheti, mbushet edhe arka e shtetit edhe pse jo, ne jemi në përkrahje.

Tunë Deda: Faleminderit, Asdren! A ka dikush tjetër? Atëherë, unë kisha propozuar me rekomanduar për kuvend dhe kuvendi duhet marr vendim rreth kësaj pike. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim të dy lokaleve të cilat janë pronë komunale, duke marr parasysh interesin e komunës, ku me këtë rast komuna do të inkasojë mjete financiare nga dhënia në shfrytëzim e këtyre lokaleve, me 6 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4.Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2024.

Tunë Deda: Referon drejtori i Financave, z.Enver Berisha.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, përshëndetje për gjithë! Ashtu siç e thotë Ligji për Buxhet dhe Ligji për Financa Publike, jemi të obliguar të raportojmë çdo tremujor raportin financiar para kuvendit. Edhe kësaj here kemi përgatitur një raport dhe besoj materialin e kemi marr me kohë. Ky buxhet i këtij viti ka qenë i planifikuar 15,676,260.00 euro dhe ky buxhet është i kategorizuar për kategori të caktuara, siç është grandit qeveritar, të hyrat vetanake, të hyrat e bartura, grandit i donatorëve dhe grantit i donatorëve të jashtëm.

Grandit qeveritar për këtë vit ka qenë 13,212,457.00 euro; të hyrat vetanake për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara 1,436,260.00 euro; të hyrat e bartura janë 940,000.00 euro, dmth janë mjetet e bartura nga viti 2023; grandit i donatorëve 64,507.00 euro; grantit i donatoreve të jashtëm 18,341.00 euro dhe; grantit i jashtëm i performancës 2,575.00 euro; dmth në total 15,676,260.00. Prej këtyre, këto janë të kategorizuara edhe në kategorinë e shpenzimeve, siç janë kategoria e pagave, kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kategoria e subvencioneve, kategoria e komunalive dhe kategoria kapitale, që është një vlerë më e madhe se të gjitha të tjerat. Dmth për paga dhe mëditje kalimi ka qenë 7,936,857.00 euro, prej kësaj janë shpenzuar 6,125,776.00 euro, apo 77.8% ; në mallra dhe shërbime, planifikimi i buxhetit ka qenë 1,870,

000.00 dhe shpenzime tash është 1,302,000.00 apo 72.04% ; në shërbime komunale kanë qenë të planifikuara 270,000.00, janë shpenzuar edhe 212,281.00 euro, apo 78.62% ; në subvencione transfere kanë qenë të planifikuara 673,759.00, janë shpenzuar deri tash 345,238.00 apo 51.24% dhe; në kapitale kanë qenë të planifikuara 4,987,996.00 euro, apo shpenzime deri tash janë bërë 3,455,000.00 apo 60.29%. Në total, shpenzimet e këtij projektbuxheti janë 73% e që në raportin kohor edhe në realizmin e të hyrave vetanake nga 1,430,000.00 euro. Janë realizuar të hyra 1,222,000.00 deri tash, dmth komuna ka realizuar jashtëzakonisht shpenzimin e buxhetit në mënyrë racionale dhe krahasuar me vitin e kaluar dmth shpenzimi është enorm më pozitiv dhe më mirë sesa ka qenë vitin e kaluar, apo vetëm në kapitale është 48.96% më shumë apo 50% më shumë sesa vitin e kaluar, dmth jemi konform kohës, konform buxhetit që kemi dhe unë besoj që deri në fund të vitit komuna e Klinës do t'i ofrohet 100 % të shpenzimit të buxhetit dhe do të mbërrij me i realizuar planifikimet e tyre vetanake dhe me e tejkaluar këtë planifikim, faleminderit!

Tunë Deda: Faleminderit, drejtor! A ka dikush rreth kësaj pike të rendit të ditës? Atëherë, unë jam i mendimit me rekomanduar për kuvend, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2024, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që raporti të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajit shtator-tetor.

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga z. Gjevdet Fejza Prebreza për marrje në shfrytëzim të pronës me numër: P-71011030-00116-0 ZK Drenoc, pasi që e njëjta gjendet afër shtëpisë së tij dhe se do ta shfrytëzonte për mbjellje të drurëve dekorativ duke e pastruar nga shkurret dhe mbeturinat.

Tunë Deda: Nëse ka dikush rreth kësaj, urdhëroni?

Asdren Ramadani: Unë sa e pash dmth kërkesën e qytetarit, kjo kërkesë ka qenë e njëjta edhe para dy viteve, edhe duke parë në çfarë gjendje të mjerueshme është në bazë të fotove, unë kisha kërkuar që të kalojë si pikë e rendit të ditës në kuvend dhe kuvendi ta shqyrtojë.

Tunë Deda: A ka dikush tjetër? Unë e kam një propozim, që kjo të shkojë në zyrën e kryetarit dhe të parashihet lista për dhënie në shfrytëzim edhe me siguri që ka me marr ai përgjigjen se është edhe në interes të komunës për ta dhënë. Kush është për?

-Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Gjevdet Fejza Prebreza, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit, ku do të vepronet sipas Ligjit Nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga znj.Filloreta Gashi, Klinë, e cila thekson se vuan nga një sëmundje e rënd (kancer) andaj në pamundësi t'i mbulojë shpenzimet financiare për shërim, kërkon ndihmë financiare.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për ndihmë financiare të parashtruar nga znj. Filloreta Gashi, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e kryetarit.

Pika 6. Të ndryshme.

Tunë Deda: A ka dikush në të ndryshme? Atëherë, faleminderit shumë për pjesëmarrje!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

**Zv.KRYESUESI,
Tunë Dedaj**